

# BASHKIA PUSTEC

## Njoftim për vend të lir pune për pranimin në nivelin e mesem në shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin

Në zbatim të Ligjit nr.152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” dhe VKM nr.520 datë 25.07.2019 Për miratimin e rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin Kreu i III “Ndarja e Funkcioneve, nivelet, detyrat, procedurat e përzgjedhjes për emërim, lirim pezullim dhe përjashtim”, VKB nr.71 datë 24.12.2020 për “Miratimin e Buxhetit të Bashkisë së Pustec për vitin 2021”, Urdhërit të Kryetarit 10 date 22.01.2021 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Sektorit të MZSH Bashkia Pustec”, Sektori I Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Pustecit njofton se në Sektorin e MZSH-së shpallet:

### 1 vend i lire pune në pozicionin:

- Shef Sektori, 1 (një) pozicion (niveli mesëm)

### *Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës*

- Shërbimi i MZSH-së është një strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme, misioni i të cilës është inspektimi, parandalimi me masat e marra për mbrojtjen nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkatuara nga dora e njeriut.
- Shefi I MZSH-se, roli I mesem derjtues.
- Organizon, drejton, koordinon veprimtarinë e shërbimit të MZSH për ndërhyrjen në rastet e shuarjes së zjarreve, shpëtimin e jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut;
- Drejton shuarjen e zjarreve masive dhe kryerjen e veprimeve nga personeli zjarrfikës për shpëtimin e jetës së njerëzve dhe pronës;
- Organizon punën për kontrollin e masave të mbrojtjes nga zjarri nëpërmjet inspektimeve të programuara dhe të autorizuara të objekteve në territorin e bashkisë në përputhje me parimet e legjislacionit në fuqi;

- Përgjigjet për gatishmërinë e stacioneve zjarrfikëse, për automjetet dhe pajisjet zjarrfikëse për rritjen e efikasitetit në ndërhyrjen në kohë për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e jetës së njerëzve në rastet e fatkeqësive të ndryshme;
- Vlerëson miratimin e projekteve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, çdo projekt të aplikuar në bashki si dhe çdo ndryshim destinacioni të përdorimit të objekteve apo aktiviteteve të ushtruara në to , për masat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;
- Bashkëpunon me strukturat e pushtetit vendor për organizimin e punës për ngritjen e strukturave vullnetare të mbrojtjes nga zjarri dhe përshtatjen profesionale të tyre sipas përcaktimeve të ligjit 152/2015;
- Organizon stërvitje demonstrative me komunitetin dhe me subjekte të ndryshme mbi dhënien e njohurive të mbrojtjes nga zjarri.

### ***Kërkesat e përgjithshme për pranimin***

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
- ç) Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucionet e tjera të administratës publike;
- d) Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
- dh) Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- e) Të mos ketë rekorde kriminale në organet e policisë dhe prokurorisë (vërtetim personaliteti nga organet e policisë dhe prokurorisë).
- f) Të ketë përfunduar testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë ose në qendra të trajnimit zjarrfikës;
- g) Të jetë me vendbanim sa më pranë stacionit të MZSH-së;
- gj) Për gjininë mashkullore personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) cm.
- h) Për gjininë femërore, personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) cm.
- i) Të jetë me peshë trupore që t'i përgjigjet raportit të gjatësisë.
- j) Të jetë i pajisur me dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të grupit "C";
- k) të ketë përfunduar arsimin e lartë policor, ushtarak, juridik ose inxhinieri, niveli minimal i diplomës "Bachelor"; c) të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar; ç) të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, i Policisë së Shtetit apo nga institucione të tjera të administratës publike; d) të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale me dashje.

### ***Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit***

### **Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

1. Formular aplikimi për pranim në shërbimin e MZSH-së. (Për të marrë formularin e aplikimit klikoni këtu: )
2. Fotokopje e kartës së identitetit ;
4. Çertifikatë familjare;
5. Një kopje të jetëshkrimit( CV);
6. Një numër kontakti (e-mail) si dhe adresën e plotë të vendbanimit;
7. Fotokopje deftesë pjekurie;apo diplome.
8. Raport mjeko-ligjor nga autoriteti kompetent, që vërteton “gjëndje të mirë shëndetsore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar”;
10. Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, si dhe nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor;
11. Vërtetim i gjendjes Gjyqesore (Dëshmi Penaliteti )/ Formular vetëdeklarimi ;
12. Fotokopje të librezës së punës e njësuar me origjinalin (nëse ka);
14. Çertifikata, trajnime profesionale, në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (nëse ka);
15. Fotokopje të dëshmisë së aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit “C”;
16. Dokument i lëshuar nga institucionet shëndetësore që vërteton se nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
17. Fotografi (2.5 x 3.5 cm), 2 (dy) copë

### **Dokumentat duhet të dorëzohen në sportelet e Sektorit të Informimit dhe Shërbimeve për Qytetarët në Bashkinë e Pustec brenda datës 21.06.2021**

#### ***Rezultatet për Fazën e Verifikimit Paraprak***

Në përfundim të afatit të verifikimit paraprak, Bashkia Pustec do të shpallë në faqen e internetit të Bashkisë Pustec dhe në stendat e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e aplikimit, të kërkuara më sipër si dhe për datën, vendin dhe orën e zhvillimit të procedurave.

Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Pustec. Afati i ankimimit është 2 (dy) ditë nga data e shpalljes së rezultateve të verifikimit

#### ***Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurimi***

- Ligjin nr.139, date 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji nr.152, datë 21.12.2015 ‘Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe

shpëtimin”.

- VKM nr. 520 dt.25.07.2019 “Për miratimin e rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri ”

### ***Mënyra e Vlerësimit të Kandidatëve***

Kandidatët që kualifikohen për të vazhduar procesin e pranimit në shërbimin e MZSH-së u nënshtrohen fazave të konkurrimit, sipas rendit të mëposhtëm:

- a) Testim me shkrim;
- b) Testim i aftësive fizike;
- c) Intervistë me gojë;
- ç) Testimi psikologjik;
- d) Verifikim përfundimtar i aplikantit.

### ***Procedura e konkurimit do të ndjekë këto faza:***

- Testimi me shkrim, shërben për të vlerësuar nëse aplikanti zotëron njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për kryerjen e detyrave të punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Aplikantët që kanë marrë 70% të pikëve të përcaktuara për testin me shkrim, do të njoftohen për të vazhduar procesin e testimit të aftësive fizike.

- Testimi i aftësive fizike, teston aftësitë psiko-motore, ku përfshihen: shpejtësia, shkathtësia fizike, rezistenca, forca muskulare dhe koordinimi fizik, të domosdoshme për punën e punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Aplikantët që kanë marrë mbi 60% të pikëve maksimale vazhdojnë procesin e testimit.

- Intervista me gojë konsiston në testimin e aftësive të aplikantit për të komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe koncepte, si dhe për të analizuar e për të marrë vendime.

- Testimi psikologjik konsiston në vlerësimin e aftësive të kandidatit për të reaguar në

mënyrën e duhur në kushtet e një stresi minimal;

Rezultati i përgjithshëm i aplikantit përcaktohet si shumatore e rezultatit të testimit me shkrim 50% dhe rezultatit të intervistës me gojë 50%.

Kandidatët fitues do të renditen sipas pikëve të mara dhe përzgjedhja e kandidateve për tu emëruar do të fillojë nga kandidati fitues që ka marrë më shumë pikë.

Spektori I Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Pustec do të shpallë fituesit në faqen e internetit të Bashkisë Pustec dhe në stendat e informimit të publikut. Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve

Njerëzore të Bashkisë Pustec. Afati i ankimit është 5 ditë nga data e shpalljes së rezultateve të testimit.

Sektori I Burimeve Njerëzore